



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2021

Lënda: Kthim përgjigje

ZNJ. _____

E nderuar,

Në përgjigje të shkresës suaj të administruar me nr.862 prot. datë 18.01.2021, në lidhje me situatën e strehimit në Bashkinë Shkodër, sipas kërkesave tuaja, ju sqarojmë si më poshtë:

Numri i aplikimeve për programet e strehimit social ne Bashkinë Shkodër për periudhën 2015-2020 është 383 aplikues ndërsa gjatë vitit 2020 janë paraqitur 163 aplikime për strehim;

Për të mbështetur familjet e pastreha, Bashkia Shkodër ka zbatuar tre Programe të strehimit social:

- Subvencionimi i interesave të kredise, ku është miratuar lista prej 103 përfituesish të cilët mund të lidhin kontratë me institucionet financiare për të përfituar kredi të lehtësuara nga shteti.
- Subvencionimi i qirasë në treg të lirë, nga ky instrument financimi për zbatimin e programit të strehimit të banesave sociale me qira janë miratuar për të përfituar 44 përfitues.
- Akordim i Grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët për dy individë/familje që plotësojnë kriteret e përcaktuara.

Programe strehimi në zbatim të projekteve që synojnë përmirësimin e kushteve të strehimit:

- Banesa sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen nr. 6”, një projekt rikonstruksioni të ish konviktit të shkollës Pyjore dhe përshatatjen për strehimin e

kategorive në nevojë siç janë jetimëve që dalin nga institucionet rezidenciale dhe familjet njëprindërore në kushte të vështira social ekonomike, ku përfitojnë 24 individë/familje.

- Jemi në proces të zbatimit të programit të strehimit në zbatim të projektit: “Rikonstruksion i godinave në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri godina, me kontenier 1+1 dhe 2+1)”. Nga ky program do të përfitojnë 27 familje rome që janë banore të Bashkisë Shkodër.

Disa projekte të tjera që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi nga Bashkia Shkodër për përmirësimin e kushteve të strehimit të banorëve janë:

- Në vitin 2016 u aplikua pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe u realizua rikonstruktimi i 9 banesave të banorëve përtej Urës së Bunës.
- Aplikim pranë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë për përmirësimin e kushteve të banimit në lagjen Mark Lula duke siguruar kryerjen e punimeve dhe furnizimin me ujë të pijshëm për rreth 3000 banorë.
- Në proces punimesh është rikonstruktimi i ish konviktit të shkollës Veterinare në fund të punimeve pritet të sigurohen 28 apartamente me qira për familjet më në nevojë.
- Aktualisht po përgatitemi të aplikojmë për Thirrjen e vitit 2021 pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Bashkia Shkodër është në proces të vlerësimit dhe hartimit të Strategjisë për Strehimin Social. Grupet me vulnerabël që trajtohen me prioritet janë: gratë kryefamiljare, jetimët e dalë nga institucionet rezidenciale, personat me aftësi kufizuar etj.

Për vitin 2021 është parashikuar një fond prej 1,453,500 për bashkëfinancimin e programit të subvencionimit të qirase në tregun e lire, si dhe nga rialokimi i fondeve gjendje të papërdorura të vitit 2020 do të përdoren për bashkëfinancim të projektit që do të aplikojmë pranë ministrisë për vitin 2021.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

KRYETAR

Voltana Ademi